



- Të Reja ▾ Policia e Shtetit ▾ Historik i shkurtër i Policisë së shtetit shqiptar Shërbime ▾ Baza ligjore Vendndodhjet e policisë Video
- Programi i transparencës ▾ Kontakt Denonco Krimin Kibernetik Drejtoritë Vendore të Policisë ▾ Policia Kufitare ▾ Policia Rrugore ▾
- Donacione Rubrika Policimi në Komunitet ▾ Përmbledhja Javore Për sinjalizimin

Breaking News: DVP Fier – Vijon operacioni policor i koduar “Takimi i fundit”
Skrapar – Ndalohen 3 shtetas të dënuar secili me 1 vit e 4 muaj burgim
Lushnjë – Vihen në pranga 2 shtetas
Tepelenë – Procedohen penalisht 4 shtetas
DVP Vlorë/Vihen në pranga 4 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 3 të tjerë, për vepra të ndryshme penale

Lajmet Operacionet

05/10/2023

Rrëshen, Mirditë – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Start”

Rrëshen, Mirditë/Sekuestrohen një kallashnikov dhe municion luftarak, vihet në pranga poseduesi.

Finalizohet operacioni policor i koduar “Start”, bazuar në informacionet e siguruara në rrugë operative për një shtetas që mbante armë zjarri.

Kapet dhe vihet në pranga 20-vjeçari që posedonte armën e zjarrit kallashnikov, i cili gjatë ndjekjes nga Policia, nuk i është bindur urdhrit të punonjësve të Policisë, për të ndaluar automjetin.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Mirditë, bazuar në informacionet e siguruara në rrugë operative se një shtetas posedonte armë zjarri, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Start”, për kapjen dhe vënien në pranga të këtij shtetasi.

Si rezultat i operacionit u arrestua në flagrancë shtetasi P. T., 20 vjeç, banues në Rrëshen, Mirditë, për veprat penale “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” dhe “Mosbindja ndaj urdhrit të punonjësve të policisë së rendit publik”.

Gjatë operacionit, në Rrëshen, shërbimet e Policisë kanë lokalizuar automjetin e këtij shtetasi dhe i kanë bërë shenjë për të ndaluar. Shtetasi P. T. nuk i është bindur urdhrit për të ndaluar dhe ka vijuar lëvizjen me shpejtësi, por falë veprimeve të shpejta është kapur nga shërbimet e Policisë.

Në vijim të veprimeve procedurale, gjatë kontrollit, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan një armë zjarri kallashnikov me një krehër me 27 fishekë.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për veprime të mëtejshme.

angazhim

perkushtimsakrificë



tëvendosurkundërkrimit



nëçdoskajtëvendit



nëshërbimtëqytetarëve



denonconë112



Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month ▾

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ DVP Elbasan/Vihen në pranga 2 shtetas dhe procedohen në gjendje të lirë 2 të tjerë, për vepra të ndryshme penale

Manzë – Finalizohet operacioni policor i koduar “Types 2” ▶